



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Elisa Spiropali – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit "Për buxhetin e vitit 2019".

Votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit "Për buxhetin e vitit 2019".

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Edlira Bode, Almira Xhembulla dhe Nuri Belba.

Mungojnë:

Petrit Vasili, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Vangjel Tavo, Halim Kosova, Bardh Spahia, Florda Kërpaçi dhe Grida Shqina.

Të ftuar:

Merita Xhafaj - Drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Saimir Kadiu - Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Flutra Beqo - Drejtoreshë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Denada Seferi - Drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Florian Nurçe - Përgjegjës në Sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Vilma Çauholli - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Esjola Mullaymeri - Specialiste në Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Elisa Spiropali – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen. Sot jemi mbledhur për të shqyrtuar nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”.

Të ftuar në këtë mbledhje kemi prezentë: zonjën Merita Xhafaj, drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zotin Saimir Kadiu, drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, zonjën Flutra Beqo, drejtoreshë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe zonjën Denada Seferi, drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kemi ftuar zotin Florian Nurçe, përgjegjës në Sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave kemi të ftuara zonjën Vilma dhe zonjën Esjola Mullaymeri.

Përpara keni të gjithë një tabelë të opinioneve dhe të grupeve të interesit për projektbuxhetin e vitit 2019 e më konkretisht, nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, nga Shoqata e Invalidëve të Punës, nga Shoqata e të Verbërve, nga *Save the Children*, nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, nga Rrjeti i Fuqizimit të Grave në Shqipëri, nga Fondacioni *Syndrom Down Albania* dhe nga shoqata “Ndihamoni jetën”.

Unë nuk do t’i rilexoj propozimet dhe komentet e tyre, sepse ju i keni përpara, por do të doja që përfaqësuesit e ministrisë të merrnin fjalën për të thënë, nëse i kanë reflektuar disa prej propozimeve dhe ku mund të ndërhyjmë në buxhet për t’i akomoduar ato.

Faleminderit!

Merita Xhafaj – Faleminderit zonja kryetare!

Ne kemi qenë edhe në seancën dëgjimore dhe kemi përpara tabelat e opinioneve dhe të propozimeve të grupeve të interesit. Me pjesën e parë do të merret Ministria e Financave, sepse ajo është një kërkesë nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, që i drejtohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Shoqata e Invalidëve të Punës i drejtohet po ashtu, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Për pjesën e Shoqatës së të Verbërve do të doja t’ju sqaroja se janë trajtuar si shqetësime 2 VKM. Në fakt, VKM-ja nr. 131 nuk është i lidhur me të ardhurat ekonomike dhe nuk është

kushtëzuar pagesa e aftësisë së kufizuar me të ardhurat ekonomike. Ky është një interpretim jo i saktë nga Shoqata e të Verbërve, por realisht, sikurse edhe ju e dini, ne jemi në një proces reforme të aftësisë së kufizuar. Shumë shpejt do të kalojë për miratim në qeveri dokumenti i politikave për aftësinë e kufizuar dhe në këtë dokument politikash, të gjitha pagesat në *cash* janë trajtuar sipas nozologjive të sëmundjeve dhe grupmoshave të të sëmurëve me aftësi të kufizuar. Në këtë kontekst, të gjitha problematikat e ngritura nga Shoqata e të Verbërve janë pjesë dhe janë reflektuar në këtë dokument. Kjo është arsyeja që në projektbuxhetin e këtij viti kemi parashikuar fondin e pagesave në *cash* për aftësinë e kufizuar, por paralelisht, kemi parashikuar edhe kërkesat dhe nevojat e tyre për t'u ardhur në ndihmë me shërbime sociale.

Një nga elementët e tjerë është edhe mekanizmi i fondit social, i cili në nivel lokal do të mbulojë të gjitha shërbimet e munguara për aftësinë e kufizuar. Qëndrimi ynë është që kjo të mos merret në konsideratë për të bërë ndryshime në projektbuxhetin e vitit 2019, që ne kemi hartuar dhe propozuar.

Nga ana tjetër, *Save the Children* targeton 4 nga 7 programet buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, targeton në mënyrë direkte fëmijët në përgjithësi dhe ata me aftësi të kufizuar, shërbimet e kujdesit parësor, të kujdesit dytësor, shërbimet e shëndetit publik dhe të përkujdesit social. Buxheti në këto programe ka një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2018. Rritjen më të madhe e ka programi i përkujdesit social me 7,2%.

Nuk reflektohen objektiva të qarta në lidhje me fëmijët, mbështetur në dokumentet politike. Ka 2 aspekte ku ne punojmë me fëmijët dhe për të cilat *Save the Children* është një nga partnerët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Së pari, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve;

Së dyti, mbrojtja e fëmijëve, si element dhe si strategji më vete.

Në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, problematikat janë *crosscutting*, buxhetet janë të alokuara nga Ministria e Arsimit, e cila merret me edukimin dhe është një element bazë për përfshirjen e fëmijëve.

Po kështu, mbrojtja sociale dhe mbrojtja e shëndetit janë pjesë e politikave dhe të projektbuxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Sikurse e dini, te politikat që adresojnë mbrojtjen e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka në fokus mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve dhe të nënave. Këtë e pasqyrojnë jo vetëm projektbuxheti dhe politikat e hartuara, por edhe në relacion ne jemi shprehur qartë,

prandaj nuk shohim ndonjë element që të mund të sjellë ndryshime në projektbuxhetin për të cilin jemi mbledhur sot për ta kaluar nën për nën.

Lidhur me kujdesin parësor, atë dytësor dhe atë terciar, realisht fondi është i shtuar dhe brenda këtij fondi të shtuar, natyrisht, për buxhetin e vitit 2019 janë parashikuar edhe mënyrat se si do të trajtohen qoftë gratë shtatzëna, qoftë fëmijët në moshën 0-3 vjeç dhe mbi 3 vjeç. Në këtë kontekst, ne jemi duke punuar paralelisht edhe me INSTAT-in në mënyrë që të dhënat statistikore dhe indikatorët të jenë të përputhur.

Po kështu, shumë shpejt do të kalojë në qeveri edhe ICD 10, e cila propozohet nga INSTAT-i në bashkëpunim me ne, me qëllim që edhe klasifikimi i nomenklaturës të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare të OBSH-së.

Lidhur me njësitë e vetëqeverisjes vendore, edhe ato do të mbulohen dhe do të kontribuojnë me një fond, i cili do të jetë pjesë e fondit social. Janë hartuar në 16 njësi të vetëqeverisjes vendore planet e veprimit për fëmijët. Janë duke u hartuar në 30 të tjera. Janë buxhetuar dhe realisht, janë pjesë e planeve sociale, që edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore janë duke diskutuar me këshillat bashkiake, për miratimin e buxheteve në mbështetje të veprimeve që ne duhet të marrim për mbrojtjen e fëmijëve.

Lidhur me pjesën e komenteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, më duket se Ministria e Arsimit e sqaroi më qartë fondin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Granti i punës për kërkimet shkencore dhe për veprimtarinë krijuese parashikohet jo më pak se 5% e totalit të grantit vjetor.

Në fakt, ministria e ka konsideruar si një partner shumë potencial Universitetin e Mjekësisë në Tiranë, sikurse në të gjitha, jo vetëm në politikat që janë shprehur në programet buxhetore për vitin 2019, por edhe në relacionin e projektbuxhetit, është shprehur qartë bashkëpunimi shumë konstruktiv me Universitetin e Mjekësisë në Tiranë. Një nga elementet ku ne kemi bashkëpunuar dhe vazhdojmë të bashkëpunojmë janë kontratat që lidhim së bashku në lidhje me specialistët e rinj në fushat dhe profilet e ndryshme pas përfundimit të universitetit për mjekët.

Po kështu, pjesa e edukimit në vazhdim të menaxherëve të sistemit spitalor dhe të kujdesit parësor dhe atij dytësor në shëndetësi, janë totalisht të lidhura me Universitetin e Mjekësisë, për shkak se edhe trajnuesit janë marrë nga pedagogët që japin mësim në këtë universitet.

Natyrisht, përfshirja e tyre në studimet shkencore do të jetë prezente dhe është parashikuar edhe për vitin e ardhshëm, për shkak se të gjitha studimet e fizibilitetit, strategjitë, sikurse edhe aktualisht Strategjia e Mirushqyerjes së Fëmijëve është duke u hartuar me prezencën e përfaqësuesve dhe pedagogëve të këtij universiteti.

Lidhur me rrjetin “Aven” për mbrojtjen dhe fuqizimin e gruas në Shqipëri, paketa e mbrojtjes sociale ka parashikuar disa prioritete. Gratë kryefamiljare lidhen me 12% të numrit të përfituesve.

Do të doja t’ju bëja me dije se ne kemi filluar të draftojmë ligjin e ri “Për ndihmën ekonomike”, i cili do të quhet ligji “Për mbrojtjen sociale”, kjo për shkak se Kryeministri ka shprehur nismën për mbështetjen e grave kryefamiljare me asistencë sociale, kryesisht duke pasur në fokus fuqizimin e familjes, përtej bonusit të bebes, që tashmë është pjesë e programit të përkujdesjes shoqërore, i parashikuar për vitin 2019, edhe ligji i ri për ndihmën ekonomike ka në fokus pikërisht problematikat e ngritura nga rrjeti “AWEN”. Kjo nuk afekton në vlerën totale të programit të përkujdesjes shoqërore, i cili është pjesë e programit buxhetor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Lidhur me shërbimet e kujdesit social, edhe këto janë të parashikuara në ligjin e ri “Për shërbimet sociale”, është miratuar një pjesë e akteve nënligjore të kësaj pakete dhe, sikurse jua përmenda pak më parë, fondi social është një mekanizëm financiar, i cili do të mbulojë të gjitha nevojat për shërbimet sociale.

Lidhur me fondacionin “*Down Syndrome Albania*”, në këtë pikë rimbursimi i analizës gjenetike të kariotipit është parashikuar në buxhetin e vitit 2019. Ne jemi dakord të merret në konsideratë nga komisioni kërkesa e bërë nga fondacioni në fjalë, pasi është e parashikuar edhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, nga njëra anë, duke pajisur me pajisjet e reja të nevojshme për ta bërë këtë analizë gjenetike në spitalin apo maternitetin “Mbretëresha Geraldinë” dhe në maternitetin tjetër, investim i cili është i parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2019. Kjo do të thotë që kjo lloj analize nuk ka nevojë për pjesën e rimbursimit, por do të bëhet e mundur direkt nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit dhe nga vetë institucionet publike.

Lidhur me shoqatën “Ndihmoni jetën”, ajo që parashikohet dhe kërkohet për t’u përjashtuar nga taksat dhe barra që shkaktojnë taksat, sidomos për ndërtesat dhe truallin ku ato kanë ngritur shërbimet e tyre dhe ofrojnë shërbime për personat dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, i takon Ministrisë së Financave për t’u shprehur.

Ky është qëndrimi ynë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi edhe një propozim tjetër.

Elisa Spiropali – Pra, si për fondacionin “*Down Syndrome Albania*”, ashtu edhe për shoqatën “Ndihmoni jetën”, të dyja sugjerimet e tyre ju jeni treguar të gatshëm për t’i përfshirë në buxhet.

Merita Xhafaj – Po.

Elisa Spiropali – Pra, konkretisht, rimbursimi i analizës gjenetike të kariotipit të rimbursohet nga shteti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj – Ne u shprehëm se do ta bëjmë ne në institucionet publike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka nevojë të rimbursohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në vitin 2019 do të bëhet falas.

Elisa Spiropali – Kur parashikohet të përfshihet?

Merita Xhafaj – Parashikohet që në janar të vijë pajisja e re në maternitetin “Mbretëresha Geraldinë”.

Elisa Spiropali – Dakord.

A keni një përgjigje lidhur me përjashtimin e organizatave që kanë statusin jofitimprurës, të cilat ofrojnë shërbime për grupet në nevojë, apo do të përgjigjen përfaqësuesit e Ministrisë së Financave për këtë gjë?

Merita Xhafaj – I takon Ministrisë së Financave, por unë do të doja t’ju thosha edhe diçka tjetër, që, për shkak të anëtarësimit në Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile, udhërrëfyesi i ri, i rishikuar për bashkëpunimin e qeverisë me shoqërinë civile, ka parashikuar edhe ndryshimet respektive, së pari, në ligjin për regjistrimin e OJF-ve, nismë që duhet të ndërmerret nga Ministria e Drejtësisë, sepse aktualisht OJF-të regjistrohen vetëm në gjykatë.

Së dyti, është parashikuar nisma tjetër për financimin e organizatave të shoqërisë civile, që do të ndërmerren nga Ministria e Financave.

Së treti, pjesa e udhëzimit për TVSH-në në blerje, sepse organizatat jofitimprurëse nuk kanë TVSH në shitje.

Përtej kësaj, ne kemi një kërkesë. Është bërë një gabim te projektbuxheti, ku kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nga projektbuxheti dhe ligji i kaluar nga qeveria këtu është që fondi prej 1 miliard, i parashikuar në programin e kujdesit shëndetësor parësor, t'i kalojë shërbimit spitalor, sepse ka qenë një gabim gjatë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Saimir Kadiu – Jo, nuk është thjesht gabim, por do ta sqaroj vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është vetë brenda buxhetit. Nuk bëhet fjalë kur ka mbaruar faza e dytë e PBA-së, se ka një lloj difference me atë që Ministria e Financave ka kaluar në qeveri për buxhetin tonë. Konkretisht, janë rritur me mbi 1 miliard kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe janë ulur te shërbimi spitalor.

Tani, ne kërkojmë vetëm një lloj rregullimi. Meqenëse kontributet kanë kaluar në vlerën 13 miliardë e 729 milionë lekë, kundrejt një shifre gati 1 miliard lekë më pak, që ishte në PBA, ne ta ulim në 1 miliard kujdesin parësor dhe këtë 1-miliardësh ta kalojmë te shërbimi spitalor. Domethënë, është një lloj sistemimi brenda buxhetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për këtë do t'ju sjellim një shkresë zyrtare sot që kjo të reflektohet edhe në mënyrë formale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te shërbimi spitalor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dini pse? Sepse është vetëm një rregullim aritmetik. Kur është bërë faza e dytë e PBA-së, që është dorëzuar në Ministrinë e Financave më 31 gusht, mendohej që kontributet e sigurimeve shëndetësore do të ishin në masën 12 miliardë e 700 milionë lekë, diçka e tillë, por, nëpërmjet ligjit të buxhetit, që ju ka ardhur juve për miratim, ka rritur me 1 miliard kontributet, ka ulur me 1 miliard spitalet. Ndërkohë, ne duam ta bëjmë këtë lloj sistemimi, sepse kjo na krijon pastaj probleme në ndarjen e buxhetit të spitaleve për vitin e ardhshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – U është rritur kontributeve, këtë e kuptoj, por pse u janë ulur spitaleve?

Saimir Kadiu – Sepse ka pasur disa rregullime të tjera, si, për shembull, është shtuar te mbrojtja sociale, u shtua 2-miliardëshi i bebeve... Domethënë, është bërë një lloj rregullimi i ri brenda buxhetit, që është menduar për ne.

Kërkesa jonë është thjesht një sistemim.

Elisa Spiropali – Po, zonja Spahiu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me mikrofon, ju lutem!

Klodiana Spahiu – Kur u bë diskutimi në parim, në fakt, këtu kishim ministren, e cila na dha edhe një informacion në lidhje me menaxhimin e ri që do të bëhet me operatorin e kujdesit shëndetësor.

Nuk e di si është në buxhetin e vitit 2019, sepse ne na ka ardhur përsëri me buxhet historik. Nëse ky projekt do të jetë i realizuar në vitin 2019, si keni parashikuar ta menaxhoni, sepse nëse do të realizohet dhe të hyjë në funksion, e gjithë Shqipëria do të ndahet në katër rajone? A do të ketë mbivendosje kompetencash ndërmjet Fondit dhe këtij operatori? Si do të funksionojë, le të themi, ky buxhet që do të ketë njëri rajon, do të realizohet që në buxhetin e këtij viti, pra në vitin 2019, apo ne do ta presim në vitin 2020? Si e keni menduar ju ose si është koncepti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Saimir Kadiu – Çdo gjë është efektive, pra gjatë vitit 2019.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Së dyti, ne e kemi përfshirë këtë. Po të flasim në aspektin konkret se ku është, ne i kemi lënë te shërbimi publik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të gjitha fondet janë te programi i shëndetit publik.

Nuk bëhet fjalë që ne po rrisim numrin e punonjësve, sepse i gjithë stafi burokratik ose, më mirë të themi, teknokratik që do të kenë këta operatorë, do të jetë brenda numrit të punonjësve që ka pasur edhe këtë vit Ministria e Shëndetësisë. Pra, ka disa pakësime dhe disa shtesa.

Operatori kryesor, ai qendror, që do të jetë në Tiranë, do të ketë gati 47 punonjës. Problemi i tyre është i tillë, që ata do të operojnë me atë buxhet sipas programeve që ju i keni në ligjin e buxhetit. Kjo do të thotë se edhe nga 1 janari i vitit 2019 buxheti shkon fundor, domethënë e merr spitali iks ose qendra shëndetësore iks, por ndryshon koncepti në aspektin e menaxhimit të tyre, pra do të ketë një menaxhim më të thellë brenda një rajoni për të parë problematikën që ka një rajon i tërë, duke e adresuar nga buxheti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shembulli është i tillë. Ne kemi Shërbimin Social Shtetëror, i cili ka një buxhet të caktuar brenda programit të përkujdesjes sociale, por ka edhe një buxhet që për vitin 2019 është rreth 900 milionë lekë të rinj, ku përfshihen 29 institucione sociale, si: jetimoret e të tjerë. Është e njëjta gjë. Domethënë, këtu bëhet fjalë për një lloj lëvizjeje në superstrukturë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merret me administrimin, e rregullon atë, por kjo nuk ka efekte financiare.

(Deputetja Spahiu flet pa mikrofon.)

Klodiana Spahiu – Ju kuptoj shumë mirë në logjikë, por dua të di: këtë vit do ta realizoni kështu? Shtroj pyetjen: do të vazhdojë po kështu, apo do të ndryshojë në vitin 2020? Domethënë, në vitin 2020 ne do të gjejmë...

(Deputetja Spahiu flet pa mikrofon.)

Për rajonin Dibër, Durrës, Tiranë, që do të menaxhohet nga një operator?

Saimir Kadiu – Ajo del në mënyrë aritmetike, sepse siç do të kenë spitalet, shumatorja e të gjitha entiteteve, atyre shpenzuese, ai do të jetë buxheti që do të ketë një rajon.

Klodiana Spahiu – Ju kuptova, por unë pyeta: planifikimi që do të bëjmë në buxhetin e vitit të ardhshëm, do të jetë i tillë si ky, apo në bazë të planifikimeve që ju do të bëni...?

Saimir Kadiu – Sipas planifikimit gjithmonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj – Ja, ta plotësoj unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga pikëpamja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ekzakt.

Nga pikëpamja e funksionimit, sot ne kemi DRSH-të, ARSH-në, të cilat do të mblidhen të gjitha tek operatori. Ne kemi bërë gati edhe rregulloren, përveç akteve të tjera, numrit të punonjësve të miratuar e të tjerë.

Në janar të vitit 2019 do të bëhet funksional operatori i ri, i cili do të mbulojë kujdesin shëndetësor parësor dhe dytësor, pra nuk e mbulon terciarin. Aktualisht, për të gjitha strukturat, sikurse thotë zoti Kadiu, numri në total nuk do të ndryshojë.

Klodiana Spahiu – Nuk e kam fare këtu. Për këtë që thoni ju jam shumë e qartë, ndërkohë pyes për mënyrën e menaxhimit në të ardhmen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj – Tani, në qoftë se do të flasim për menaxhimin financiar, ne nuk do t'i ndryshojmë programet buxhetore. Programet buxhetore janë ato që janë. Ndërkohë, sot në ligjin e buxhetit flasim për programe buxhetore që menaxhon Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndër të cilët kemi programin buxhetor spitalor dhe programin buxhetor parësor. Të dyja këto programe punojnë në funksion dhe ushqejnë me financim pikërisht operatorin që do të jetë ombrella e të gjithë...

Klodiana Spahiu – Merita, të kuptoj shumë mirë, por Saimiri e di pse e bëj unë pyetjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A do të vazhdojë ende me buxhete historike financimi i spitaleve, apo do të ndryshojë kjo gjë? Vetëm kaq dua të di, sepse ky është thelbi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Saimir Kadiu – Jo, problemi është i tillë që, po të arrijmë te buxhetet sipas performancës, është një rrugë...

Klodiana Spahiu – Ky është pikërisht thelbi i pyetjes. Në qoftë se kjo gjë nuk ndryshon, është...

(Zoti Kadiu flet pa mikrofon.)

Saimir Kadiu – Në fund të fundit, këtu po punohet paralelisht me Ministrinë e Financave për sistemet e PBA-ve, në mënyrë që çdo gjë të shkojë deri në kosto produkti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto, si të thuash, janë tullat e para që krijojnë diçka më të favorshme për ne për të zgjedhur. Për shembull, buxhetet historike. Nuk mund të flas për to, sepse ne kemi një trend

trevjeçar 2019-2021. Ne e dimë deri ku shkojnë mundësitë financiare që ka shteti për shëndetësinë. Në qoftë se do të bëjmë *wishing budget*, kam idenë se do të kërkonim dyfishin. Por problemi është që këto janë mundësitë. Madje ne kemi përdorur tani buxhete historike, sepse jemi bazuar më tepër edhe te mundësitë financiare, sepse po të kishte buxhete...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj – Ajo që thoni ju lidhet me reformën në shëndetësi, e cila nuk bëhet dot në një vit apo në një ditë.

Klodiana Spahiu – Jo, Merita...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, por është tjetër gjë pyetja që bëra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dini ku e kam shqetësimin? Për shembull, spitali rajonal i Durrësit ka kaç vite që është sistem pilot dhe mendoj që buxhetin e ka pasur të veçantë, jo me buxhet historik.

Tani, do të vazhdojë po njëlloj, apo ky operatori, që do të jetë për të gjithë këtë zonë, do të shohë se shërbimi iks sa shtretër ka dhe sa e shfrytëzon shtratin, se, në fund të fundit, ky është qëllimi.

Merita Xhafaj – Patjetër.

Klodiana Spahiu – Atëherë, në qoftë se ky shërbim iks nuk e realizon shfrytëzimin e shtratit mbi 60% ose 70%, çfarë do të ndryshojë në këtë rast?

Saimir Kadiu – Ai nuk do të ketë politikë qarku, por politikë rajonale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Dakord pra. Në rregull.

Atëherë, në bazë të këtyre vendimeve, do të ndryshohen dhe do të ketë reflektime në buxhetin e ardhshëm?

Saimir Kadiu – Patjetër.

Klodiana Spahiu – Në rregull.

Faleminderit!

Merita Xhafaj – Edhe unë këtë po thosha, që të gjitha këto që thoni ju janë vënë në detyrat dhe përgjegjësitë e operatorit të ri. Pikërisht këtë gjë do të bëjë operatori i ri, sepse në detyrat dhe përgjegjësitë e tij do të ketë pikërisht analizën e situatave, shfrytëzimin e kapaciteteve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku tentojmë? Tek autonomia. Që të kemi autonomi, duhet të kemi patjetër një analizë shumë të detajuar të shfrytëzimit të kapaciteteve në secilin institucion të kujdesit shëndetësor. Por edhe protokollet do të jenë të kostuara.

Elisa Spiropali – Është e qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e kanë kërkuar zonja Bode dhe zoti Pendavinji.

Edlira Bode – Nëse e kuptova drejt, se ka shumë vite që spitali i Durrësit është pilot, a do të vazhdojë tani të shtrihet kjo përvojë në spitalet e tjera rajonale, apo secili spital do të krijojë përvojën e tij?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Të dëgjojmë edhe pyetjen e zotit Pendavinji dhe pastaj përgjigjet shkurtimisht.

Ilir Pendavinji – Në fakt, ndoshta më ka shpëtuar si përgjigje, por dua të di: sa është buxheti për fondin për lindjet e reja që nisin nga viti 2019?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

2 miliardë? Është i parashikuar për lindje të parë, të dytë, të tretë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Saimir Kadiu – 2-miliardëshi ka dalë nga një studim demografik që ka bërë INSTAT-i se çfarë ka ndodhur me vitin 2017.

Merita Xhafaj – Janë 30 mijë lindje në vit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji – Po në lindjet plus 3, si vijohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj – Njësoj.

Është dhënë një deklaratë dje në diskutimin që bëmë me Kryeministrin për projektbuxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Ilir Pendavinji – Nuk kam qenë, prandaj pyes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj – Sqarimi ka qenë për rastin kur lind binjakë dhe trinjakë, sepse kjo është pyetja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk flasim kur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo.

Saimir Kadiu – Marrim shembull fëmijën e njëmbëdhjetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj – Për fëmijën e katërt e të tjerë do të shohim një politikë të re.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Po, doktor Kamami.

Arben Kamami – Kam një pyetje.

(Diskutime në sallë)

Buxheti i urgjencës do të jetë i ministrisë apo do të bëjë pjesë te buxhetet e spitaleve, pra këto të fundit do të ngarkohen me shërbim urgjence?

(Zoti Kadiu flet pa mikrofon.)

Saimir Kadiu – Kemi dy aspekte urgjence.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Kamami – Më thjesht fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, më dëgjo!

Kam një eksperiencë jo të mirë nga historia e dializës. Në një kohë kur dializa ishte buxhet i spitalit, trajtoheshin me dializë edhe banorë jashtë qendrave që duhej të mbulonte buxheti i spitalit. Realisht tani është krijuar Qendra Kombëtare e Urgjencës. Pagesa dhe të gjitha shpenzimet do t'u kalojnë spitaleve apo qendrës?

(Zoti Kadiu flet pa mikrofon.)

Saimir Kadiu – Domethënë, është aspekti makro i të gjithë problematikës.

Ndërsa ajo ka një buxhet të caktuar...

Arben Kamami – Ndërsa personeli, harxhimet e të gjitha të tjerat do të vazhdojnë të jenë te spitali?

Saimir Kadiu – Patjetër, atë që e ka spitali, e ka spitali.

Kjo kryesisht ka të bëjë me menaxhimin total të flotës së automjeteve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, shpenzim qendror.

Elisa Spiropali – Ju lutem, një përgjigje nga përfaqësuesit e Ministrisë së Financave për çështjet që kanë ngritur grupet e interesit, pra jo për ato që nuk do të bëni, por për ato që do të bëni.

Vilma Çausholli – Faleminderit!

Në fakt, këto çështje janë duke u diskutuar ende në Ministrinë e Financave dhe unë nuk mund të jap një konkluzion për secilën nga kërkesat që kanë paraqitur sindikatat dhe grupet e interesit. Unë mund të them vetëm se nga ana jonë janë studiuar, sepse edhe ne kemi kontaktuar me grupet e interesit dhe kemi menduar se kemi arritur më të mirën e mundshme në marrjen e kërkesave të tyre. Megjithatë, unë mund të them se në lidhje me ministrinë...

Elisa Spiropali – Çfarë do të thotë se keni marrë më të mirën?

Vilma Çausholli – Sigurisht...

Elisa Spiropali – Keni reflektuar diçka?

Vilma Çausholli – ...në përputhje edhe me mundësitë buxhetore. Për shembull, në lidhje me pagat e arsimtarëve, shtesa e pagave të tyre është një politikë që po vazhdon në rritje, duke u fokusuar pikërisht te mësimdhënia, duke përjashtuar të gjithë pjesën tjetër administrative apo ndihmëse të sistemit të arsimit, me qëllim fokusimin dhe rritjen e pagave pikërisht tek arsimtarët.

Edhe për vitin 2019 është parashikuar një fond dhe një rritje, ne themi maksimale, sepse maksimalisht 7% e kemi rritjen, për disa nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë, ku përfshihet i pari sektori i arsimit, i cili merr edhe fondin ose, të themi, gjysmën e fondit të parashikuar për të gjithë politikën e rritjes së pagave. Përfituesit janë të ndjeshëm, mbi 35 mijë punonjës mësimorë, por edhe fondi është i konsiderueshëm në nivel vjetor që shkon për mësuesit.

Kjo rritje e pagave do të vazhdojë...

Elisa Spiropali – A parashikohet rritja e pagës minimale në projektbuxhetin e vitit 2019?

Vilma Çausholli – Normalisht në çdo vit është parashikuar rritja e pagës minimale dhe çdo vit është bërë pothuajse me një shumë...

Elisa Spiropali – Sa shkon paga minimale?

Vilma Çausholli – Është një parashikim me rritje 1 mijë lekë në muaj, pra paga minimale në muaj shkon 25 mijë lekë, flas në nivel kombëtar, sepse për punonjësit buxhetorë kjo pagë është pak më e lartë.

Elisa Spiropali – Sa është aktualisht?

Vilma Çausholli – 24 mijë. Por duhet të kini parasysh që kjo pagë është e lidhur me shumë elemente të tjera për të arritur edhe në rritjen e kësaj page prej 1 mijë lekësh, që pothuajse ne e kemi bërë të përvitshme. Kemi pasur edhe këtu diskutime shumë të gjata, jo vetëm me palën e sindikatave dhe konfederatave, por edhe me punëdhënësin, sepse edhe për ata kostoja është objekt diskutimi apo debati të vazhdueshëm, por të paktën, në dijeninë time, ne ia kemi dalë që të kemi çdo vit një rritje të menduar të pagës minimale.

Elisa Spiropali – A keni bërë ju një parashikim se sa kohë do të duhet që paga minimale të arrijë në nivelin e kërkuar nga sindikatat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vilma Çausholli – Kjo çështje diskutohet në shumë grupe të caktuara, pastaj edhe në Komitetin Kombëtar të Punës, por kjo do të shihet më tej. Nuk mund ta themi në këtë kontekst...

Elisa Spiropali – E qartë.

Vilma Çausholli – ...sepse kjo duhet parë edhe me rritjen ekonomike. Janë të lidhura shumë ngusht me mënyrën se si do të jetë ecuria dhe treguesit makroekonomikë.

Elisa Spiropali – Ju e keni parashikuar rritjen ekonomike për dy vitet e ardhshme. Nuk është se nuk e keni të parashikuar, apo jo?

Vilma Çausholli – Po, e kemi të parashikuar.

Elisa Spiropali – Dakord! E mbledhni Komitetin Kombëtar të Punës? Ka ankesa, prandaj po të pyes.

Flutra Beqo – Komiteti Kombëtar i Punës mbledhet. Të them të drejtën, ka qenë një funksion shumë i rëndësishëm i ish-Ministrit të Punës. Tashmë kjo tashmë është bashkuar me Ministrinë e Financave, por në dijeninë time është mbledhur dhe janë bërë diskutime.

Elisa Spiropali – Pra, nga një funksion shumë i rëndësishëm, ka ardhur te ministria juaj dhe është bërë një funksion i parëndësishëm, përderisa nuk vështirë mbledhur.

Kush është zëvendësministri që mbulon çështjet e punës? Dajna Sorensen?

Flutra Beqo – Dajna Sorenson.

Elisa Spiropali – Po ju pyes, sepse ka ankesa nga konfederata dhe sindikatat e tjera, se komiteti nuk është mbledhur, se ata nuk thirren e të tjera.

Flutra Beqo – Të jap një përgjigje sa për sqarim. Mbledhja e komitetit është më datën 23. Mbledhja e komitetit ka në analizë ndryshimet në ligjin “Për promovimin dhe nxitjen e punësimit”.

Po kështu, do të diskutohet edhe Kodi i Punës?

Elisa Spiropali – Më datë 23?

Po, më datë 23. Paralelisht është edhe Komiteti Palëve. Ka edhe një komitet tjetër trepalësh, i cili funksionon te Agjencia Kombëtare e Punësimit. Për shkak se jam përfaqësuese nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, mund t’ju them se si funksionon. Kjo nuk vendoset dot nga asnjë institucion shtetëror, qoftë në nivel qendror, ngaqë është një raport ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve. Pa u dakordësuar në Komitetin Kombëtar të Punës, është e pamundur.

Kur është bërë diskutimi dhe është arritur rritja nga 22 në 24...

Elisa Spiropali – Ndjesë, zonjë! Paga minimale nuk kërkon dakordësinë e punëdhënësve.

Flutra Beqo – E kërkon.

Elisa Spiropali – Të lutem!

Flutra Beqo – E kërkon domosdoshmërisht, në bazë të kartës sociale.

Elisa Spiropali – Po, dakord. Po të jetë për punëdhënësit, paga minimale nuk rritet kurrë.

Flutra Beqo – Kanë argumente edhe sindikatat, forumi i sindikatave. Janë dy, të ndara, nuk është një, dhe duke qenë dy, mendimet i kanë të ndryshme, sepse vetëm sindikalistët, një pjesë janë të interesuar ta rrisin pagën minimale, një pjesë nuk janë të interesuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka mundësi. Kjo duhet parë në raportin punëdhënës-punëmarrës, dhe nuk ka të bëjë fare as me Ministrinë e Financave e as me institucionet shtetërore. Në qoftë se...

Elisa Spiropali – Jo pra, nuk është kështu, sepse shteti garanton disa standarde. Nuk mund të vendoset vetëm në një marrëdhënie dypalëshe mes punëdhënësve e punëmarrësve. Nëse ju përmendni sindikata që nuk duan rritjen e rrogës së punonjësve, nuk janë sindikata, por grupe private interesi.

Flutra Beqo – E para, diskutohet nëse forma e kontratës është kontratë individuale apo kontratë kolektive, sepse ka efekte të diferencuara.

Elisa Spiropali – Prandaj, ky komitet duhet mbledhur, dhe ministria duhet të garantojë se aty mbrohet dhe interesi i punonjësve, kjo është çështja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, mund të vazhdoni.

Vilma Çausholli – Gjithsesi, edhe unë kam qenë pjesë e këtij komisioni. Ne jemi në komisionin trepalësh, që është përbërë nga Ministria e Financave dhe Ministria e Punës. Janë edhe të gjitha sindikatat, si punëmarrësit ashtu edhe punëdhënësit. Gjithmonë kemi pasur diskutime me argumente pro e kundër, në lidhje me arritjen e kësaj rritjeje, dhe është rënë dakord me të gjitha palët: punëdhënësit e punëmarrësit. Këtë e them nga eksperiencia.

Elisa Spiropali – A ka reflektime të tjera nga Ministria e Financave?

Vilma Çausholli – Në lidhje me reflektime të tjera mund të themi se në ligjin e buxhetit është parashikuar edhe indeksimi i pensioneve. Sigurisht, e dëgjojmë shpeshherë edhe në terminologjinë e gazetave, por edhe nga sindikatat, kërkesën për rritjen e pensioneve.

Tashmë, me reformën në pensione, sistemi është kontributiv. Ka qenë gjithmonë, por tashmë është fokusuar në parimin e kontributivit. Ligji i pensioneve dhe sigurimeve shoqërore nuk parashikon në asnjë rast rritje pensionesh, por vetëm indeksim të tyre. Në këtë kontekst, nuk duhet të fokusohen të gjitha kërkesat për ndërhyrje të politikave të qeverisë në rritjen e pensioneve, por vetëm në indeksimin e këtyre pensioneve. Pak a shumë, edhe për vitin 2019 është parashikuar indeksimi i pensioneve deri në 3 %. Kjo kërkesë është marrë në konsideratë.

Kërkesat e tjera janë duke u shqyrtuar edhe nga drejtoritë përkatëse, sepse kanë të bëjnë edhe me taksat dhe tatimet. Pra, janë çështje në diskutim.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Faleminderit!

A ka ndonjë ndërhyrje nga Ministria e Arsimit?

Florian Nurçe – Unë dua të sqaroj vetëm diçka: tek elementët e rritjes së pagave, përfshihen jo vetëm mësuesit në sistemin arsimor, por edhe edukatorët në sistemi arsimor parauniversitar. Në relacionin e projektligjit parashikohet se do të përfitojnë 35. 700 punonjës, nga të cilët rreth 29, 000 janë në sistemin e Ministrisë së Arsimit, ndërsa 4. 400 janë edukatorë

në sistemin arsimor parauniversitar, por që tani punojnë në njësitë e qeverisjes vendore. Ka edhe disa gjëra të tjera që mund t'i sqaroj, nëse kanë mbaruar kolegët.

Elisa Spiropali – Për sa u përket opinionëve dhe propozimeve?

Florian Nurçe – Po. Unë e sqarova edhe në takimin që kishim javën e kaluar në komision, edhe në dy takimet që kanë pasur organizatat e shoqërisë civile në Ministrinë e Arsimit, kanë kërkuar shtimin e punonjësve psikosocialë. Tanimë ata janë shtuar dhe kanë arritur në 600 punonjës, me një kosto financiare 551 milionë lekë.

Elisa Spiropali – Sa kanë qenë?

Florian Nurçe – Kanë qenë 100 – 150; në vitin 2018 janë konsoliduar dhe në sistem janë 600 punonjës, me një kosto financiare që është brenda buxhetit të parashikuar për Ministrinë e Arsimit. Kanë kërkuar shtimin e punonjësve ndihmësmësorë, një praktikë e futur në tre vitet e fundit. Të dhënat e fundit konfirmojnë se tani, në sistemin arsimor, janë 940 punonjës ndihmësmësorë. Këta kanë një kosto të parashikuar në buxhet, brenda buxhetit vjetor e trevjeçar: 851 milionë lekë.

Kanë kërkuar shtimin e sigurisë nëpër shkolla. Janë miratuar me vendim qeverie 150 oficerë sigurie, të cilët nga janari 2019 do të jenë në punë. Edhe këta kanë një kosto në buxhet. Do të jenë për 150 shkolla. Janë të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe kanë një kosto financiare prej 125, 8 milionë lekë.

Rritja dhe promovimi i shkollave kombëtare. 270 shkolla, të cilat kanë marrë statusin shkollë kombëtare, sipas përlllogaritjeve të normave mësimore dhe të personelit që punon, në këto shkolla janë 132 punonjës në vit, me një kosto mesatare prej më shumë se 121 milionë lekë.

Vetëm për kërkesat apo katër indikatorët, që kanë kërkuar shoqëria civile dhe sindikatat, ne kemi më shumë se 1, 7 miliardë lekë shpenzime nga buxheti i shtetit, për të përballuar këto produkte që ka kërkuar shoqëria civile.

Ajo që dua të theksoj përsëri, është se buxheti i Ministrisë së Arsimit është shumë social. Janë më shumë se 2 miliardë lekë, që shkojnë:

Për tekste falas. Për 220 fëmijë, ne kemi parashikuar 650 milionë lekë. Këtë vit kanë marrë 190 mijë fëmijë tekste falas, me shumën 620 milionë, ndërsa për vitin 2019 është parashikuar të përfshihen nga klasa e parë te e pesta, si dhe shtatëmbëdhjetë kategori sociale, nga e para deri te e dymbëdhjeta. Janë 650 milionë lekë.

Ofrojmë transport për 32 mijë fëmijë dhe presim që me riorganizimin e klasave kolektive, kemi parashikuar që ky numër të arrijë deri në 35 mijë. Kemi parashikuar edhe një buxhet, i cili është 650 milionë lekë. Ky është po ashtu i kostuar dhe i mbuluar në buxhetin e parashikuar 2019 – 2021.

Elisa Spiropali – Unë kam një pyetje në lidhje me rimbursimin për fëmijët. E di që e ngrenë shpesh këtë çështje, por ka zona të largëta, ku prindërve u kushton më shumë ta çojnë fëmijën në afërt, se sa të kenë rimbursimin që ju u jepni, 800 lekë të vjetra, më duket.

Florian Nurçe – Po, 800, 900, 950,

Elisa Spiropali – Si parashikohet të zgjidhet kjo?

Florian Nurçe – Në shtator të këtij viti ne i kemi çuar një letër ministrit të Transporteve dhe ministrit të Financave, që vendimi i cili parashikon tarifat e udhëtarëve për të gjitha sistemet e transportit automobilistik, hekurudhor apo të tjera, që kjo tarifë të ndryshojë. Kjo tarifë ka më shumë se 13 vjet që nuk ka ndryshuar.

Elisa Spiropali – Cili është propozimi juaj? Sa duhet të shtohet?

Florian Nurçe – Propozimi ynë është të shtohet me 30 %, që asnjë prind apo qytetar të mos e fusë dorën në xhep për të marrë shërbimin arsimor.

Elisa Spiropali – Kjo është e domosdoshme.

Florian Nurçe – Me Kushtetutë, shërbimi arsimor është falas, dhe fëmija duhet të shkojë në shkollë dhe ta marrë edukimin falas.

Elisa Spiropali – Atëherë kur do të implementohen kjo masë?

Florian Nurçe – Ne e kemi çuar shkresën dhe presim përgjigje, që të dyja ministrinë të ndryshojnë vendimin dhe të rishikojnë tarifat. Ne kemi parashikuar që ky projektvendim të ketë efekte financiare nga 130 në 150 milionë lekë shtesë.

Elisa Spiropali – Le të ketë. Është e domosdoshme.

Florian Nurçe – Këtë letër e ka bërë ministrija dhe presim përgjigje nga dy ministrinë, që janë përgjegjëse...

Elisa Spiropali – Dhe janë shumë, nuk janë pak zonat ku transporti është i keq.

Florian Nurçe – Keni të drejtë, janë shumë. Janë 32 mijë fëmijë, si dhe 12 mijë mësues, pra përfituesit shkojnë deri në 45 mijë.

Elisa Spiropali – Dakord!

Po, zonja Bode!

Florian Nurçe – Edhe dy gjëra të tjera.

Elisa Spiropali – Ju lutem, një ndërhyrje nga deputetja, e pastaj ju.

Edlira Bode – Ju përmendët personelin mësues ndihmës.

Florian Nurçe – Po.

Edlira Bode – Thatë se që nga tetori janë 900 të gjithë Shqipërinë? Apo e dëgjova unë gabim?

Florian Nurçe – Po.

Edlira Bode – Nuk pritet rritje e numrit të këtyre mësuesve ndihmës në janar?

Florian Nurçe – Numri i mësuesve parashikohet në ligj. Nëse do të ndryshojë struktura brenda numrit të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit, që ju e keni mbi tavolinë, mund të ndryshojë; nga 710 që e kishim në shtator, ka arritur në 940.

Edlira Bode – Kur u rrit? U rrit tani, në shtator-tetor, këtë vit të ri mësimor?

Florian Nurçe – Tani, në shtator-tetor, këtë vit të ri mësimor. Nëse komisionet që verifikojnë nxënës me aftësi të veçanta, apo nëse në klasa, në shkolla ka nevoja të tjera, konform trupës pedagogjike që është, mund të shtohet. Por numri është i miratuar.

Edlira Bode – Krahasuar me numrin e përgjithshëm të fëmijëve me aftësi ndryshe, që ne kemi sot, si jemi me numrin e mësuesve ndihmës? Pra, në qoftë se kemi 920 mësues ndihmës, sa fëmijë kemi? Më rezulton se në zonën që unë përfaqësoj, në Devoll, kemi një të tretën e mësuesve ndihmës, krahasuar me numrin e fëmijëve, ndërkohë që është thënë vazhdimisht e do të shkojmë drejt barazimit të numrit të fëmijëve me numrin e mësuesve. Pra, do të arrijmë të kemi një mësues për çdo fëmijë me aftësi ndryshe. A është ruajtur ky raport në çdo zonë të Shqipërisë apo ka diferenca? Atje ku jam unë raporti është një me tre, në mos më pak.

Florian Nurçe – Diferenca nuk ka. Vlerësimin e bëjnë komisionet zonale, komisionet e zyrës, komisionet e zyrës, komisionet e drejtorive arsimore. Nëse mund të ketë më tepër nga sa kemi ne mundësi të burimeve njerëzore, sepse burimet njerëzore miratohen me ligjin vjetor, 30 mijë punonjës, dhe ministri i Arsimit urdhëron më datën 3 janar 30 mijë punonjës. Nëse në DAR-in e Devollit del se për 1200 nxënës duhen 1200 mësues, kur ne kemi atje 340 mësues për gjithë sistemin arsimor, nuk e di se si mund...

Edlira Bode – Unë po flas për mësues ndihmës, jo për mësues.

Florian Nurçe – Po pra, por numri i mësuesve ndihmës është brenda numrit të mësuesve të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit, brenda punonjësve të arsimit parauniversitar. Nëse nuk ka mundësi...

Edlira Bode – Që do të thotë se në janar mund të kemi ndryshim të këtyre shifrave?

Florian Nurçe – Në janar mund të ketë ndryshim, por brenda numri të miratuar të punonjësve për Ministrinë e Arsimit.

Elisa Spiropali – Mirë. tani edhe çështjet e fundit që kishit, referuar propozimeve.

Florian Nurçe – Në qoftë se sindikatat dhe OJF-të kanë kërkuar më shumë për studentët, ju sqaroj se vetëm bursat që japim për ciklin e parë të studimeve në universitete kanë një kosto financiare prej 400 milionë lekësh të reja. Vetëm studentët që përjashtojmë nga bursat, nga tarifat e shkollimit, kanë një kosto financiare për universitetet, prej 150 milionë lekësh të reja. Vetëm bursat e ekselencës, që kanë marrë studentët për këtë vit akademik 2018-2019, janë 200 milionë lekë të reja.

Vetëm këto pesë tregues apo produkte, Ministrisë së Arsimit i shkojnë më shumë se 2, 2 miliardë lekë në buxhetin e vitit 2019 apo në buxhetin e saj vjetor. Po t'i mbledhësh të tetë produktet, janë më shumë se 4 miliardë lekë, të cilat kanë vetëm karakter social.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Faleminderit juve!

Nëse nuk ka ndonjë koment tjetër ose shtesë, i falënderoj përfaqësuesit e ministrive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër.

Ilir Pendavinji – Doja të bëja një pyetje zotërisë së Ministrisë së Arsimit. Shkollat private nuk janë përfshirë në fondin e ekselencës dhe në bursa. Ka ndonjë shpjegim?

Florian Nurçe – Nga viti 2007 e deri tani fondi i ekselencës ka qenë fond ekselence në dy fasha: fond ekselence për studentët shqiptarë që studiojnë në universitetet publike në Republikën e Shqipërisë, dhe fond ekselence i veçantë për studentët shqiptarë që aplikojnë dhe pranohen në 15 universitetet më të mira apo në doktoraturë në 300 universitetet më të mira. Kusht për studentët ekselent shqiptarë është që të jenë me nota 10. Në vendim është parashikuar nota e ekselencës: 10.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo në zbritje, jo 9, 8. Çdo student që ka shkuar në 15 universitetet më të mira të botës ka marrë bursë. Ka marrë bursë 10 mijë euro, 30 mijë euro apo deri dhe në 90 mijë dollarë. Nëse shkon në Harvard vajza jote, vëllai yt, ju vetë apo unë vetë, nesër mund të aplikoni në Ministrinë e Arsimit dhe mund të merrni bursën aq sa është kostoja për të studiuar në një universitet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë vit, e plotë, bashkë me koston e jetesës, bashkë me një udhëtim vajtje ardhje 800 dollarë, apo 350 euro në Europë. Nëse doni informacion, mund t'jua dërgojmë.

Elisa Spiropali – Domethënë, le të themi se është 50 mijë dollarë në vit. Për të katër vitet?

Florian Nurçe – Për të katër vite, ne i kemi dhënë bursë prej 300 mijë dollarësh një studenti të caktuar, i cili mbaron në Harvard, Oksford. Numri i studentëve e ka lakuar 250-ën dhe po shkon 300. Vetëm këtë vit, 35 studentë kanë marrë 2 milionë dollarë.

Elisa Spiropali – Kjo është gjë shumë e mirë.

Florian Nurçe – Mund ta verifikoni.

Nëse ju i dërgoni zyrtarisht, ne ju kthejmë përgjigje zyrtarisht.

Elisa Spiropali – Po, do ta marrim këtë informacion, se qenka shumë interesante që paska kaq shumë studentë që marrin bursa. Ka kusht për t'u kthyer?

Florian Nurçe – Po, në kontratë ka kusht kthimi, që të paktën tre vjet të punojë në Shqipëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, familjet dhe ata që kanë fëmijë duhet të ndjehen krenarë. Shqiptarët duhet të ndjehen krenarë, sepse kemi studentë të ekselencës nga Zelanda e Re në Kanada.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Cilin rankim konsideroni? Cilët janë 15 universitetet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të “The Times”. Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë të hapura, transparente.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është investim shumë i mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë atëherë, falënderojmë të gjithë përfaqësuesit e ministrive, që janë këtu, dhe vazhdojmë me diskutimin e buxhetit nen për nen e pastaj me votimin.

Ju jeni të lirë të vazhdoni, se keni edhe punë të tjera.

Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin nen për nen, e pastaj votimin në tërësi të buxhetit për vitin 2019. Votimin në parim e kemi kryer.

Neni 1: Të ardhurat, shpenzimet, deficitit.

Besoj është e qartë.

Ka propozime? Jo. hedhim në votim nenin 1.

Kush është dakord? Pro? Kundër s'ka? Abstenim s'ka?

Neni 2: Pro? Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet.

Neni 3. Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 3. Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 4. E hedhim në votë.

Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 5. E hedhim në votë.

Po, dhjetë vota pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 6.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 7.

Kush është pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Kreu II: “Burimet për mbështetjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit”.

Vijojmë me nenin 8.

Pro? Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 9. E hedhim në votë. Pro? Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Kreu III: “Shpenzimet e buxhetit të shtetit”.

Vijojmë me nenin 10.

Pro? Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 11. E hedhim në votë.

Pro? Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 12: “Paga e Presidentit të Republikës”.

Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 13.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 14.

Pro? Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 15. E hedhim në votë.

Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 16.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 16.

Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 17.

Pro të gjithë. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 18.

Pro 10. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 19.

Pro të gjithë. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 20.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 21.

Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 22.

Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 23: Hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Pro të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Hedhim në votë projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019” në tërësi.

Të gjithë pro. Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Faleminderit shumë të gjithëve!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA